



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Radio Kosova e Lire”

Pronar – Ahmet QERIQI

Radio KOSOVA E LIRË

Rr/ Thimi Mitko, Nr.6

Prishtinë

Ref:1703/205/KPM/am

V E N D I M

për ripërtëritjen e licencës së transmetimit të Radio Kosova e Lirë, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Kosova e Lirë është subjekt transmetues me mbulueshmëri regionale, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në Komunën e Prishtinës, me seli në Prishtinë në regjionin e Prishtinës. KPM, me datën 12 mars 2010, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Kosova e Lirë.
3. Me datën 12 mars 2017, afati i licencës së Radio Kosova e Lirë ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati kishte të drejtë të kërkojë ripërtëritjen e licencës brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më datën 11 maj 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të gjithë të licencuarit lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, që të bëjnë kërkesë për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen.
5. Njoftime të ngjashme me shkrim janë ridërguar tek të licencuarit edhe më 28 qershor 2016 dhe më 10 gusht 2016, me qëllim të nxitjes së tyre për të vepruar në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, duke publikuar njoftimin e ngjajshëm edhe ne faqen e internetit të KPM-së me datën 18 gusht 2016.

6. Radio Kosova e Lirë ka shprehur interesim për ripërtëritje të licencës.

Arsyetimi

7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në dhe Vendimi i Komisionit (KPM V3-2016), i datës 29 nëntor 2016, krijojnë bazën ligjore që të ripërtëritje licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje.

VENDIM

8. Komisioni merr VENDIM për ripërtëritjen e licencës së Radio Kosova e Lirë, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, me interes publik në zonën ku operon.
9. Licenca e transmetimit të KPM-së për Radio Kosova e Lirë do të jetë e vlefshme në afat prej 7 (shtatë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 12 mars 2017.
10. Të gjitha parametrat e licencës së KPM-së, si: Kategoria e të Licencuarit, Skema Programore, Parametrat Teknik si dhe Harta e Zonës së Mbulimit, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
11. Ky vendim hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI

KRYETAR

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



10.03.2017

Datë